



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1525/1 Prot.

Tiranë, më 02 . 12 . 2024

V E N D I M

Nr. 288, datë 02 . 12 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 230 Regj., datë 07.11.2024, paraqitur nga shtetasi E. B kundër Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP) në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar formularit të ankesës së depozituar pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues, z. E. B, parashtron se:

“Kërkoj të më shpjegohet pse ky Autoritet Publik më diskriminon duke mos më kthyer përgjigje për kërkesat e mia. Kërkoj të di pse ky Autoritet Publik nuk trajton ankesat e mia. Në datën 17.10.2024 kam kërkuar të më informojnë në lidhje me moszbatimin e ligjit nr.119/2024 “Për të Drejtën e Informimit”, mosinformim i cili bie ndesh me VKM nr. 625, datë 26.10.2018”.

¹ Lidhur me këtë shkak, ankuesi fillimisht nuk ka depozituar asnjë shpjegim, fakt, parashtrim apo provë, bazuar në të cilën të prezumonte diskriminimin, por thjesht e ka shënjuar tek rubrika e shkaqeve/Formulari i Ankesës, pa e elaboruar më tej. Në vijim, nëpërmjet e-mailit datë 14.11.2024 ka dërguar kopjen e vendimit gjyqësor, ku ai është pala paditëse dhe KDIMDHP është palë e paditur, pa ndonjë shpjegim përkatës prej tij, referuar shkakut të diskriminimit.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

Nga aktet e depozituara pranë KMD-së, evidentohet se, z. B nëpërmjet e-mailit datë 04.06.2024, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-së (ILD)³ lidhur me kërkesën për informacion, duke kërkuar specifikisht si më poshtë citohet:

“Kërkoj nga institucioni juaj informacion mbi organizatorët e Konferencës së 15-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, sa është kosto e këtij aktiviteti, kush e ka paguar faturën e shpenzimeve për këtë aktivitet?”

Në kthim përgjigjen e Zyrës së ILD-së, drejtuar ankuesit nëpërmjet e-mailit datë 07.06.2024, i bëhet me dije⁴ se, kërkesa e tij i është përcjellë për kompetencë institucionit të KDIMDHP-së, duke qenë se, pavarësisht faktit se kërkesa për informacion është depozituar pranë Zyrës së ILD-së, rezulton t’i jetë drejtuar veprimtarisë së Institucionit të KDIMDHP-së.

Nga korrespondenca bashkëlidhur ankesës, vërehet se z. B, në mënyrë të përsëritur ka kërkuar të njihet me arsyet se pse kërkesa për informacion dhe ankesat e tij lidhur me mosmarrjen e tij në kohë, nuk janë trajtuar nga institucioni kompetent, KDIMDHP-ja, fakt për të cilin ka informuar edhe Kuvendin e Shqipërisë, Avokatin e Popullit dhe disa institucione të tjera.

Në përfundim të ankesës së tij, subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Zbatimin e Kushtetutës, Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe ligjeve të këtij shteti”*.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

³ Në adresën e e-mailit: info@ild.al

⁴ Duke i bashkëlidhur edhe shkresën respektive me nr. 1554/1 prot., datë 06.06.2024, të KDIMDHP-së.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë⁵”*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

⁵ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Komisioneri vlerëson se, personi i cili pretendon se është diskriminuar për këto shkaqe, por jo vetëm, duhet gjithashtu të parashtojë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë një apo më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, është “çdo shkak tjetër”.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh⁶. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1. Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁷.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës

⁶ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*’, i ndryshuar citon se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.*”

⁷ Neni 14, I KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë.

Komisioneri vlerëson se, diskriminimi⁸ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

⁸ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë apo të padrejtë e të pafavorshëm të tij, lidhur me moskthimin e përgjigjes nga ana e KDIMDHP, vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur e parashikuar nga LMD-ja.

Diskriminimi⁹ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedon atë.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces¹⁰.

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

Në informacionin e dokumentacionin e përcjellë nga subjekti ankues *fillimisht* pranë Komisionerit, në momentin e regjistrimit të ankesës, nuk është dokumentuar apo shpjeguar asnjë shkak diskriminimi. Në ankesën e depozituar pranë KMD-së, në rubrikën “Shkaku ose shkaqet për të cilat pretendohet diskriminimi”, të formularit të ankesës, citohet shprehimisht: “*Këtë dua të kuptoj edhe unë, pse më diskriminon ky Autoritet Publik*”.

Në vijim, me datë 14.11.2024, ankuesi ka dërguar disa e-maile në adresën e KMD-së¹¹, duke bashkëlidhur disa dokumente si: kopjen e Vendimit nr. 441, datë 19.02.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga ku rezulton se z. B ka paditur palën e KDIMDHP-së, me objekt: “*Shpalljen akt administrativ i paligjshëm i shkresës së Zyrës së Komisionerit me nr. 1368/1 prot., datë 29.07.2022*”.

Komisioneri vëren se, pas këqyrjes së sa më sipër, pavarësisht faktit se ankuesi nuk ka elaboruar apo shpjeguar shkakun e pretenduar të diskriminimit, fakti i dërgimit të këtij vendimi gjyqësor pranë KMD-së në mbështetje të provueshmërisë së shkakut të pretenduar prej tij, konsiderohet nga ana e Komisionerit se ankuesi ka provuar se pretendimi i tij për trajtim të padrejtë a të pafavorshëm nga

⁹ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

¹⁰ Neni 11, i Kodit të Procedurës Civile.

¹¹ info@kmd.al

KDIMDHP-ja, mund të jetë nxitur nga fakti që ai ka qenë në proces gjyqësor me palën e paditur prej tij, (duke fituar çështjen në shkallën e parë të gjykimit).

Komisioneri vëren se, kronologjia kohore e veprimeve të palëve, provohet nëpërmjet akteve si më poshtë citohen:

- Kërkesë-padia e ankuesit kundër KDIMDHP-në daton më 16.08.2022, data e regjistrimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Vendimi nr. 441, datë 19.02.2024, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Kërkesa për informacioni e kontestuar në ankesën pranë KMD-së, fillimisht daton që në 04.06.2024;
- Ankesa pranë KMD-së është regjistruar me datë 07.11.2024.

Pra, në këtë kontekst, faktin se ankuesi ka paditur gjyqësisht palën e KDIMDHP-së dhe pretendimin se nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar, pikërisht për shkak të padisë së ngritur prej tij, Komisioneri e vlerëson si shkak të mbrojtur nga LMD, referuar si “çdo shkak tjetër¹²”.

Në kuptim të LMD-së, *“Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.¹³”*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pala ankuese ka dëshmuar me fakte e prova, se mbart shkakun e mbrojtur, mbi të cilin të mund të vijohej me hetimin e ankesës, nëse ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të diferencuar, sa i takon mosmarrjes së informacionit të kërkuar dhe trajtimit të ankesave të përsëritura të tij, lidhur me këtë fakt, nga ana e KDIMDHP-së; trajtim i cili duhet të jetë motivuar pikërisht nga një shkak i mbrojtur, i provuar nga vetë subjekti ankues.

Bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe në këqyrjen e dokumentacionit bashkëlidhur, Komisioneri, lidhur me kronologjinë kohore të veprimeve të kryera nga subjekti ankues dhe subjekti juridik – KDIMDHP, kundrejt të cilit ka dhe pretendimet - objekt i kësaj ankese, lidhur me çështjen e mosmarrjes së informacionit sipas mënyrës së kërkuar prej tij, vëren se:

- Z. B nëpërmjet e-mailit datë 04.06.2024, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-së (ILD)¹⁴ lidhur me kërkesën për informacion, duke kërkuar specifikisht: *“Kërkoj nga institucioni juaj informacion mbi organizatorët e Konferencës së 15-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, sa është kosto e këtij aktiviteti, kush e ka paguar faturën e shpenzimeve për këtë aktivitet?*

¹² Për analogji citojmë: Vendimin me nr. 176, datë 02.12.2019, vendimin me nr. 151, datë 28.10.2020, vendimin me nr. 151, datë 11.08.2021, të KMD-së.

¹³ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

¹⁴ Në adresën e e-mailit: info@ild.al

- Në kthim përgjigjen e Zyrës së ILD-së, drejtuar ankuesit nëpërmjet e-mailit datë 07.06.2024, i bëhet me dije¹⁵ se, kërkesa e tij i është përcjellë për kompetencë insitucionit të KDIMDHP-së, duke qenë se, pavarësisht faktit se kërkesa për informacion është depozituar pranë Zyrës së ILD-së, rezulton t’i jetë drejtuar veprimtarisë së Institucionit të KDIMDHP-së.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 1472/1 prot., datë 19.06.2024¹⁶, KDIMDHP, nëpërmjet Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, i është përgjigjur ankuesit, duke parashtruar ndër të tjera, si vijon: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se, Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit “International Conference of Information Commisssioner-ICIC”, është forumi më i lartë dhe më i rëndësishëm i bashkëpunimit e koordinimit të autoriteteve botërore rregullatore të së drejtës për akses në informacionin publik dhe transparencën që mbledh bashkë komisionerë, ombudsmanë, organizata ndërkombëtare, shoqëri civile, media, etj. Zyra e KDIMDHP-së është anëtare e zgjedhur e Komitetit Ekzekutiv të onferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit dhe fitoi të drejtën e organizimit të edicionit të XV-të, të Konferencës.*
Zyra e Komisionerit, si organizatore e këtij edicioni, ka ndjekur procedura prokurimi online e disa operatorë ekonomikë, me burim financimi nga buxheti i shtetit. Ju sqarojmë se, deri në datë 18.06.2024 janë gjeneruar faturat e fiskalizuara në vlerën 11.727.118 lekë, për të cilat jemi në procesin e likuidimit të tyre.”

- Subjekti ankues nëpërmjet shkresës me nr. 2252 prot., datë 17.10.2024, i është drejtuar sërish KDIMDHP-së për marrjen e informacionit të kërkuar prej tij.

- Me shkresën me nr. 2252/1 prot., datë 07.11.2024, Koordinatori për të Drejtën e Informimit pranë KDIMDHP-së, ndër të tjera, ka sqaruar ankuesin se: *“...në përgjigje të kërkesës tuaj, Zyra e Komisionerit ju ka kthyer përgjigje nëpërmjet komunikimit elektronik, me shkresën nr. 1472/1 prt., datë 19.06.2024.*
Menjëherë sapo ju është dërguar elektronikisht, kërkesa juaj për informacion si dhe përgjigjja është publikuar edhe në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të Zyrës së Komisionerit.
Sa më sipër, bashkëlidhur gjeni:
 1. Kërkesën tuaj drejtuar ILD-së;
 2. Shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së ILD-së, administruar me tonën me nr. 1472/1 prt., datë 19.06.2024;
 3. Screenshot të marrë nga faqja zyrtare e Komisionerit ku vërtetohet publikimi i informacionit”

¹⁵ Duke i bashkëlidhur edhe shkresën respektive me nr. 1554/1 prot., datë 06.06.2024, të KDIMDHP-së.

¹⁶ Me lëndë: “Në përgjigje të kërkesës tuaj”.

- Në përmbajtje të e-mailit të datës 13.11.2024¹⁷, ankuesi parashtron si vijon: *“Në shkresën tuaj nr.2252/ prot., date 07.11.2024 shkruani se më keni dërguar përgjigje nëpërmjet komunikimit elektronik me shkresën nr. 1472/1 prot., datë 19.06.2024, shpreheni se përgjigja është shënuar po atë ditë në rregjistrin tuaj të ankesave në sistem!
Unë kam gjithë komunikimet me e-mail mes meje dhe autoritetit tuaj publik,ka mundësi ta kemi këtë e-mail,si informacion publik që është?!
Kërkoj të më vihet në dispozicion ky informacion publik që kam muaj që po jua kërkoj!
Ju bëj me dije se edhe nga përgjigja e ardhur,vetëm mbasi jam ankuar tek Komisioneri Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi,nuk i jeni përgjigjur kërkesës sime në kuptim të Ligjit tuaj material.
Ju sqarojmë se deri në datë 18.06.2024 janë gjeneruar faturat e fiskalizuara në vlerën 11.727.118 lekë, për të cilat jemi në procesin e likuidimit të tyre -thoni ju.
Sa është vlera e këtij aktiviteti,nuk e dini akoma dhe pse ka muaj që ky aktivitet është zhvilluar?! Nuk kam kërkuar as sa është vlera deri në këtë datë e as sa keni likuiduar deri më sot! Kërkoj ti bëni "Screenshot"edhe këti e-mail që thoni e keni dërguar edhe t'a shikojmë është çuar përgjigja apo jo,mos shkojmë kot në Prokurori!
Në të kundërt kam gjithë të drejtën të mendoj që ky informacion publik nuk ekziston!
Ky informacion publik më duhet ta dorëzoj në Prokurori si provë!”.*
- Nga korrespondenca bashkëlidhur ankesës, vërehet se z. B, në mënyrë të përsëritur ka kërkuar të njihet me arsyet se pse kërkesa për informacion dhe ankesat e tij lidhur me mosmarrjen e tij në kohë, nuk janë trajtuar nga institucioni kompetent, KDIMDHP-ja, fakt për të cilin ka informuar edhe Kuvendin e Shqipërisë, Avokatin e Popullit dhe disa institucione të tjera.

Nga këqyrja e analizimi i parashtrimeve dhe dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Lidhur me pretendimin e ankuesit se nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar nga KDIMDHP-ja , Komisioneri vlerëson se, bazuar në nenin 24¹⁸, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe

¹⁷ Drejtuar ILD-së dhe për dijëni KDIMDHP-së

¹⁸ “Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila, verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës.....”.

Mbrojtjen e të Dhënave Personale¹⁹, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në këtë Ligj.

Komisioneri, vëren se, çdo person, kur vlerëson se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji nr.119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si Institucioni dhe organi kompetent i krijuar me ligj të posaçëm.

Ankimi bëhet në rastet kur subjekti juridik, institucioni:

- refuzon dhënien e informacionit;
- nuk përgjigjet;
- kthen përgjigje pa vënë në dispozicion dokumentin e kërkuar;
- kthen përgjigje të paplotë.

Ankimimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara në këtë Ligj.

Neni 24, pika 6, e këtij Ligji, parashikon se: “Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t’iu drejtuar gjykatës.”

Kjo vlen si për ankesat e depozituara pranë KDIMDHP-së, kundrejt institucioneve të tjera, ashtu edhe për vetë këtë Institucion, duke mos e përfshirë atë nga detyrimi për dhënien e informacionit, konform parashikimeve ligjore në ligjin 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar.

Referuar sa më sipër, si dhe bazuar në përgjigjen drejtuar ankuesit nëpërmjet shkresës me nr. 1472/1 prot., datë 19.06.2024²⁰, të KDIMDHP-së, Komisioneri vlerëson si të pabazuar pretendimet e z. B lidhur me moskthimin përgjigje të kërkesës së tij.

Në kushtet kur pyetjeve të ngritura prej tij, autoriteti publik i është përgjigjur, nuk mund të konsiderohet se ka mosveprim apo mosdashje të këtij Institucioni, sa i takon pretendimit të z. B lidhur me mosvënien e informacionit të kërkuar në dispozicion të tij.

Po ashtu, lidhur me citimin e ankuesit, në e-mailin e datës 13.11.2024, drejtuar i ILD dhe KDIMDHP-së, lidhur me faktin se KDIMDHP, ka vënë në dispozicion të tij përgjigjen vetëm pas ankesës së paraqitur pranë KMD-së, Komisioneri vlerëson si të pabazuar, pasi ankesa e z. E. B është regjistruar me datë 07.11.2024 pranë Zyrës së KMD-së, ndërsa përgjigjja e KDIMDHP-së daton para në kohë, që më datë 19.06.2024 dhe përgjigjja e dytë me datë 07.11.2024.

Komisioneri evidenton gjithashtu, faktin se, pretendimet e ankuesit sipas ankesës së depozituar pranë KMD-së, nuk i janë paraqitur e bërë të njohura palës së KDIMDHP-së, në kushtet kur në vlerësimin paraprak të ankesës konkludohet se ajo nuk përmbush kriteret për të vijuar më

¹⁹ Autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është *vetë* institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

²⁰ Me lëndë: “Në përgjigje të kërkesës tuaj”.

shqyrtimin e mëtejshëm të saj. Për rrjedhojë, pala e KDIMDHP-së, nuk ka qenë në dijeni se tek institucioni i KMD-së është paraqitur një ankesë nga shtetasi E. B.

Për gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për moskthim përgjigje të KDIMDHP-së, është i pambështetur në ligj dhe i pabazuar në fakte e prova. Për rrjedhojë, nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:ç) është haptazi e pabazuar...”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.

Në mungesë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankesa e z. B, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, subjekti ankues lidhur me kërkimin e tij, për moszbatimin apo shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sa i takon pretendimit të tij për mosdhënie informacionit të kërkuar në mënyrë të plotë, manipulim apo abuzim me këtë fakt, të këtij autoriteti publik, mund t’i drejtohet organeve të drejtësisë si prokurorisë apo gjykatës përkatëse; pasi hetimi sa më sipër nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja ç), nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës me nr. 230 Regj., datë 07.11.2024, të shtetasit E. B, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

